



PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe
Mal i Zi - Kosovë 2014- 2020

Prill 2023

**FOTO: PROJEKTI PROMOVIMI I PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM TË BIMËVE AROMATIKE
DHE MEDICINALE PËR PËRMIRËSIMIN E JETESËS DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT**

PËRMBAJTJA

Edicioni i gjashtëmbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- » Hapet Thirrja e 4-të për projekt-propozime Mali i Zi – Shqipëri...2
- » Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....3
- » Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 4
- » 2.1 milionë euro për përfituesit e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi-Shqipëri.....4
- » 3.2 milionë euro mbështetje nga Bashkimi Evropian për 10 projekte ndërkufitare për programin mes Malit të Zi dhe Kosovës.....6
- » Në Prishtinë u mbajt takimi bilateral dhe ai i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit.....8
- » Në Kosovë u organizua Punëtorja për gazetarë.....8
- » Takimi i dy Kordinatorëve Kombëtar IPA në Podgoricë10
- » Ngritje kapacitetesh për përfituesit e projekteve të dy programeve.....10
- » Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të organizuara për stafin e strukturave të programit11

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.

*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Hapet Thirrja e 4-të për dërgimin e projekt-propozime Mal i Zi Shqipëri

Me datë 17 mars të vitit 2023, Ministria e Çeshtjeve Europiane dhe Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Ndihmës së BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, së bashku me Agjensinë Shtetërore të Programit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në Republikën e Shqipërisë (SASPAC) publikuan Thirrjen e 4-të për dërgimin e projekt-propozime në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërKufitar Mal Zi-Shqipëri 2014-2020.

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj thirrje është *"Promovimi/përforcimi i marrëdhënieve të mirafqinjësore dhe zhvillimit socio-ekonomik të zonës ndërKufitare, nëpërmjet valorizimit të potencialit turistik, si dhe zhvillimit ekonomik ekologjikisht të qëndrueshëm dhe , duke respektuar trashëgiminë e tyre të përbashkët kulturore dhe natyrore zhvillim e një ekonomie të qëndrueshme në aspektin mjedisor dhe gjithëpërfshirëse në aspektin social".*

Si pjesë të kësaj thirrje, do të mbështeten me deri në **900,000** euro projekte që synojnë promovimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe deri në **450,000** euro projekte që nxisin punësimin, lëvizjen e krahut të punës si dhe përfshirjen sociale dhe kulturore nga të dy anët e kufirit.

Kohëzgjatja e projekteve kufizohet deri në **36 muaj** për fushën e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe deri në **24 muaj** për fushën e punësimit, me një vlerë totale prej **2.8 milion** euro, nga e cila **85 %** është vlera e kontributit të siguruar nga BE.

Zona e programit në Mal të Zi përfshin komunat e Andrijevicës, Beranes, Plavës, Gucisë, Petnjicës, Rozhajës, Podgoricës, Tuzit, Zetës, Cetinës, Danilovgradit, Budves, Tivarit dhe Ulqinit, kurse nga ana e Shqipërisë përfshin Bashkitë e Malësisë së Madhe, Shkodrës, Vaut të Dejës, Pukës, Fushë-Arrëzit, Lezhës, Mirditës, Kurbinut dhe Tropojës.

I gjithë informacioni lidhur me Thirrjen e 4-të për dërgimin e projekt-propozime është i disponueshëm në [linkun](#).

Afati i fundit për të dorëzuar aplikimet e plota është deri me 30 qeshor të vitit 2023.



Me qëllim promovimin e Thirrjes së 4-të për dërgimin e projekt-propozime, gjatë muajit mars dhe prill janë zhvilluar 4 Sesione Informuese në Shkodër, Lezhë, Berane dhe Podgoricë. Gjatë këtyre sesioneve, përfaqësues nga Ministria e Financave e Malit të Zi



prezantuan kushtet e pjesëmarrjes në Thirrjen e 4-të për dërgimin e projekt-propozime dhe iu përgjigjen pyetjeve të ndryshme të aplikuesëve potencial.




Gjithashtu, me datë 23 mars të vitit 2023 Ministria e Financave dhe Ministria e Çeshtjeve Europiane e Malit të Zi, në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Europian në Mal të Zi, organizuan një konferencë për shtyp për mediat e Malit të Zi ku prezantuan zyrtarisht Thirrjen e 4-të për dërgimin e projekt-propozime.



Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Vihen në përdorim faqet e internetit për bimët aromatike

Komuna e Plavës, bashkia e Tropojës, OJQ Qendra për Integrim Demokratik dhe Zhvillim dhe OJF Alpet Shqiptare po zbatojnë projektin 'Promovimi i Përdorimit të Qëndrueshëm të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike për Përmirësimin e Jetesës dhe Ruajtjen e Biodiversitetit'. Pas një sërë aktiviteteve të zhvilluara në zonat veriore të Malit të Zi dhe Shqipërisë, hartat e vendodhjeve të bimëve mjekësore dhe aromatike tashmë janë të qasëshme online. Për më shumë informacion, ju ftojmë të vizitoni faqet e internetit <https://aromaticmedicine-plants.me/> dhe <https://didc-map-tropeje.al/>.



Aktivite me fokus përmirësimin dhe mbrojtjen e sistemit të shpëtimit

Falë mështetjes së Bashkimit Europian, në kuadër të projektit 'Fatkeqësitë nuk njohin kufinj 2', u organizua në Podgoricë një trajnim treditör për përfaqësues të shërbimeve hidrometeorologjike nga Shqipëria dhe Mali i Zi rreth temës Sistemi i Parashikimit dhe Paralajmërimit të Hershëm. Në trajnim morë pjesë 27 pjesëmarrës të cilët patën mundësinë të përmirësojnë njohuritë e tyre lidhur me rastet e motit ekstrem në kontekstin e ndryshimeve klimaterike, përforcimin e masave të përshtatjes së komuniteteve si dhe rezistencën ndaj fenomeneve ekstreme të motit, produktet satelitore dhe aplikimin e tyre, parashikimin e ngjarjeve ekstreme të motit nëpërmjet modeleve me rezolucion të lartë, përdorimin e parashikimeve meteorologjike për vlersimin e riskut sektorial, etj.


Trajnimi u mbajt nga trajnerë me përvojë të gjerë në këtë fushë – znj. **Natasa Strelec Mahoviq** PhD nga Organizata Evropiane për Shfrytëzimin e Satelitëve Meteorologjikë (EUMETSAT) dhe z. **Vladimir Gjurgjeviq** PhD, profesor në grupin e meteorologjisë të Fakultetit të Fizikës, Universiteti i Beogradit.



Më heret, janë organizuar gjithashtu punëtori mbi rrezikun nga përmblytjet dhe zjarret me qëllim edukimin e nxënësve rreth veprimeve që duhen ndërmarrë në rast të fatkeqësive, për të ndihmuar ata dhe familjet e tyre për të qëndruar së bashku të sigurtë. FORS Mali Zi ka organizuar gjithashtu ligjerata në bashkëpunim me shkollat dhe njësitë rajonale të Drejtorisë për Mbrojtjen dhe Shpëtimin në Ministrinë e Brëndshme të Malit të Zi. Rreth 25 ligjerata janë mbajtur me nxënës të shkollave fillore në Andrijevicë, Guci, Petnjicë dhe Berane, ku mbi 500 fëmijë morën pjesë. Me këtë rast, nxënësit morën udhëzime të posaçme nga ekspertë rreth masave parandaluese dhe veprimeve që duhen ndërmarrë në rast përmblytje apo zjarri me qëllim shmangien e dëmeve që mund të pasojnë.

Aktivite të projektit SOLUTION

Vazhdon bashkëpunimi dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve ndërmjet Qendrës për Hulumtime Ekotoksikologjike të Malit të Zi, Universitetit të Tiranës dhe OJF Qendra Gjellbër si pjesë e aktiviteteve të projektit *Skadar Lake without chemical pollution - SOLUTION*. Trajnimet e mbajtura përfshijnë tematika si teknikat GC-MS, zhvillimin e metodave analitike për instrumentin e ri GC-MS blerë për projektin SOLUTION për Universitetin e Tiranës, si dhe kalibrimin për një sërë ndotësish organik si PCB-të, Pesticidet, vajrat mineral, PAH-të etj.



Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Projektet e financuara në kuadër të programit Mali i Zi - Kosovë promovohen në panairin ndërkombëtar të turizmit

Projektet "Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës" dhe "Trashëgimia kulturore – Thesar i rajonit ndërkufitar", që janë zbatuar në kuadër të IPA II Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Kosovë, janë promovuar si pjesë e Panairit Ndërkombëtar të Turizmit "Kosova – 2023" që është mbajtur nga 16 deri me 18 mars të vitit 2023 në Prishtinë.



Key achievement of the PRAXIS project presented


Konsorciumi i ekipit të projektit, i udhëhequr nga Caritas Kosova në bashkëpunim me Caritasin e Malit të Zi, QAKP Gjon Nikollë Kazazi – Gjakovë dhe Komonën e Beranës, zbatuan projektin "PRAXIS" që synonte nxitjen e punësimit të të rinjve nga zonat e synuara në rajonin ndërkufitar dhe që rezultoi në rritjen e kapaciteteve për punësim dhe mundësi punësimi për nxënësit, studentët dhe të rinjtë e papunësuar. Ekipi i projektit publikoi rezultatet e detajuara të projektit "PRAXIS" mbi arritjet kryesore. [Këtu](#) mund të shikoni analizën dhe të dhënat.

PRAXIS Programme

Final Report on Indicators: 1-09-2020 to 31-12-2022

The MEAL System has been set up in one Excel table named "Dashboard" (annex A). It has allowed us to follow up all the proposed indicators in the PRAXIS Logframe on a monthly basis. During the 28 months project implementation, mostly "quantitative" indicators have been followed up. Here under you can read the level of Indicators' achievement after 28 months implementation of activities for the General Objective, the Specific Objective and the 4 expected results.

General Objective Indicator:



CARES 2 aktivitete të vazhdueshme për ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin

Projekti CARES 2, si vazhdimësi e rezultateve të mëparshme të projektit CARES 1, po zbatohet me sukses nga partneriteti afatgjatë ndërmjet FORS nga Mali i Zi dhe ECMI Kosova. Në kuadër të kësaj periudhe të zbatimit të projektit janë organizuar aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuëse, si dhe ekzaminime parandaluëse dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve.

Në prill të vitit 2023, në kuadër të aktiviteteve të projektit, Shtëpisë Shëndetësore "Bogdan Vujosheviq" në Ulqin iu dhuruan pajisje të vlefshme. Pajisjet dhe instrumentet e prokurimit për klinikën gjinekologjike të Shtëpisë Shëndetësore Ulqin, do të përdoren për organizimin e ekzaminimeve parandaluëse të grave në moshë riprodhuese lidhur me kancerin e qafës së mitrës. Gjegjësisht, është blerë një aparat ekografie, një thikë radiokirurgjikale dhe instrumente tjerë në vlerë të përgjithshme prej 32.360 euro.



2.1 milionë euro për përfituesit e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi-Shqipëri

Fillimi i zbatimit të gjashtë projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të Thirrjes së 3-të për Propozime u shënua më 2 Mars 2023 në Shkodër. Gjegjësisht, gjashtë projekte në vlerë prej 2.1 milionë euro do të realizohen në periudhën e ardhshme në fushën e punësimit, turizmit dhe mjedisit. Në zbatimin e projekteve do të marrin pjesë gjithsej 19 organizata dhe institucione partnere nga territori i Malit të Zi dhe Shqipërisë.



Gjatë dhënies së certifikatave për përfituesit e Thirrjes së 3-të për Propozime, Koordinatori Kombëtar i IPA-së/Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës së Shqipërisë **Z. Ilir Beqaj**, iu drejtua në fillim të pranishmëve dhe u shpreh se ky është një moment shumë i rëndësishëm për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj taksapaguesve evropianë, kontributi i të cilëve financon këtë program dhe për të konfirmuar gjithashtu angazhimin e dy vendeve tona në rrugën e integrimit evropian. **Z. Beqaj**, veçanërisht theksoi rëndësinë e adresimit të sfidave të ditëve të sotme si ato biologjike, kibernetike apo mjedisore, ku mbështetja e BE-së është thelbësore dhe shumë e nevojshme.



Pas kësaj, Shefi i Strukturës Operative të Malit të Zi në Ministrinë e Çështjeve Evropiane në Mal të Zi, **z. Bojan Vujović** iu drejtua të pranishmëve dhe vuri në dukje se bashkëpunimi ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë është veçanërisht i rëndësishëm në kuadrin e procesit të anëtarësimit, ku është e mundur të shkëmbejnë përvojë dhe njohuri nëpërmjet zbatimit të përbashkët të projekteve, në fusha me rëndësi dhe interes të përbashkët. Ai kujtoi bashkëpunimin mes këtyre dy vendeve, i cili ka nisur 15 vite më parë, dhe faktin se në kuadrin e IPA II janë financuar 21 projekte me vlerë totale prej 7 milionë eurosh në fushën e punësimit, mobilitetit të fuqisë punëtore dhe sociale dhe përfshirjen kulturore, mbrojtjen e mjedisit dhe turizmin.



Pas kësaj, **znj. Ana Raiçević**, Zyrtare Kombëtare Autorizuese në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, iu drejtua pjesëmarrësve dhe theksoi se avantazhet e programit të bashkëpunimit ndërkufitar reflektohen në krijimin e një vizioni të përbashkët për një të ardhme më të mirë për qytetarët e të dy vendeve, duke mbështetur marrëdhëniet e



fqinjësisë së mirë, duke inkurajuar integrimin në BE dhe duke nxitur zhvillimin social-ekonomik dhe, siç vlerësoi ajo, struktura e IPA-së malazeze do të përfitojë të gjitha kapacitetet e saj në dispozicion. Ajo shtoi se "*Struktura e IPA-së malazeze është e gatshme për bashkëpunim dhe mbështetje me grantet e dhëna, duke pasur parasysh qëllimin e përbashkët – absorbimin e fondeve në dispozicion të BE-së dhe përmirësimin e rrugës evropiane*".

FAKTE TË SHPEJTA - Projektet e Thirrjes së 3-të për projekt-propozime

Pa Kufi për Punë! – zbatohet nga Kryeqyteti i Vjetër Mbretëror i Cetinës, ProAct Hub, Instituti për Politika të Qëndrueshme dhe Bashkia Fushë Arrëz;

Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Mjedisit – JEPA – zbatohet nga komuna e Gucisë dhe Bashkia Pukë;

Aftësi për Punë Shqipëri - Mali Zi – zbatohet nga Qendra e Start-Up-eve dhe Themelimit të Biznesit Tivar, Oda Ekonomike e Malit të Zi si dhe Agjencia Shqiptare për Investim dhe Zhvillim (AIDA);

Realitet i Ri për Sitet e Trashëgimisë – zbatohet nga komuna e Tivarit, Bashkia Tropojë dhe Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG);

Ndërtojmë Pyje të Zgjuar – zbatohet nga Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje (FLAG), Bashkia Shkodër dhe komuna e Tivarit ;

Ujëmbledhësi i Liqenit të Shkodrës- një Reservuar i Biosferës Ndërkufitare – zbatohet nga Qendra EDEN, Programi Mjedisor EnvPro, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë dhe Ndërmarrja Publike e Parqeve Nacionale të Malit të Zi.

Drejtuuesi i Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik dhe Social në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, **z. Andrea Vera**, duke iu drejtuar të pranishmëve tha se ka një cilësi të rritur të projekteve të aplikantëve dhe përfituesve të fondeve të BE-së. Ai shtoi se bashkëpunimi ndërkufitar ka objektiva edhe më të mëdha si koordinimi i ndërsjellë i rrugëve të dy vendeve drejt BE-së dhe bashkëpunimi më i thellë e më i fortë, pasi ato të jenë pjesë e ardhshme e BE-së. "*Që nga viti 2012, BE-ja ka kontribuar me më shumë se 8 milionë euro për bashkëpunimin ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe tani të*

gjithë së bashku po punojmë në përgatitjet e fundit të IPA III me një buxhet prej rreth 12 milionë eurosh", z. Vera. përfundoi fjalën e tij.

Pas fjalëve të hapjes, Zyrtari i Projektit në Sekretariatit e Përbashkët Teknik **z. Nikolla Gjonoviç** prezantoi shkurtimisht të gjithë procesin e Thirrjes së 3-të për projekt-propozime duke filluar nga publikimi i saj. Ai informoi të pranishmit për të gjithë afatin kohor të aktiviteteve që janë ndërmarrë nga strukturat e Programit me qëllim informimin, zhvillimin e kapaciteteve të aplikantëve potencialë para dhe pas publikimit të Thirrjes. Në sesionin e fundit, përfutuesit prezantuan së shpejti projektet e tyre para pjesëmarrësve. Aktivitetet e projektit kanë për qëllim fuqizimin e të rinjve, inkurajimin e përfshirjes sociale, përmirësimin e mundësive të punësimit, mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe uljen e rrezikut të fatkeqësive në zonën e programit.



3.2 milionë euro mbështetje nga Bashkimi Evropian për 10 projekte ndërkufitare për programin mes Malit të Zi dhe Kosovës

Ceremonia solemne e ndarjes së granteve të projekteve të kontraktuara në kuadër të Thirrjes së 3-të për dërgimin e projekt-propozime të IPA programit të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi – Kosovë 2014-2020 është organizuar në Pejë nga Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Strukturën Operative të Malit të Zi, ku u prezantuan dhe u promovuan projektet e përzgjedhura në kuadër të kësaj thirrje të Programit. Publiku pati mundësinë të informohej për 10 projekte të kontraktuara, si dhe u prezantuan në detaje statistikat e rezultateve të procesit të vlerësimit.



Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal i Republikës së Kosovës, **z. Elbert Krasniqi**, përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e ngjarjes dhe shprehu kënaqësinë e tij që Kosova dhe Mali i Zi bashkërisht po finalizojnë një proces të suksesshëm të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar i cili është duke lëvizur drejt fazës së mbylljes. Ai theksoi se marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal përbëjnë parakushtet kryesore për anëtarësim, ndërsa forcimi i

bashkëpunimit ndërshtetëror dhe ndërkufitar përbën premisën kryesore të zhvillimit social dhe ekonomik.



Ai tha se bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në kuadër të IPA fondeve ka filluar në vitin 2011 dhe se dy vendet kanë punuar së bashku në kuadër të IPA II Programit në drejtim të rritjes së punësimit, mbrojtjes së mjedisit, promovimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Ai falënderoi kolegët nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Struktura Operative e Malit të Zi, Autoriteti Kontraktues pranë Ministrisë së Financave në Mal të Zi, stafin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të programit dhe përfaqësuesit e BE-së për punën, ndihmën dhe mbështetjen e tyre në arritjen e qëllimeve të këtij Programi. Ai tha se 10 projekte me vlerë 3.2 milionë euro janë kontraktuar në kuadër të Thirrjes së tretë në kuadër të IPA programit të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi – Kosovë dhe përfutuesve të projektit u uroi zbatim të suksesshëm të projekteve të tyre.



Të pranishmit në emër të Ministrisë së Çështjeve Evropiane dhe Strukturës Operative të Malit të Zi i përshëndeti **z. Miodrag Rashoviç**, ushtrues detyre i sekretarit të Ministrisë së Çështjeve Evropiane të Malit të Zi. Ai theksoi se puna e suksesshme e deritanishme në këtë Program nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunimin e mirë dhe cilësor të Ministrisë së Çështjeve Evropiane dhe Ministrisë së Financave të Malit të Zi dhe Strukturës Operative të Kosovës, Ministrisë së administrimit të pushtetit lokal të Republikës së Kosovës, Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

Ai shprehu kënaqësinë që po shenohet fillimi i projekteve të reja, duke thënë se 29 organizata dhe institucione partnere nga Mali i Zi dhe Kosova do t'i zbatojnë aktivitetet e tyre në 19 komuna të zonës së Programit. Ai tha se bashkëpunimi i suksesshëm ndërkufitar mes dy vendeve ka filluar në vitin 2011 gjatë perspektivës financiare IPA 2011-2013, ku janë realizuar me sukses 9 projekte me vlerë totale prej gati 1.6 milionë euro dhe se në kuadër të programit IPA II janë kontraktura deri më tani 23

projekte me vlerë totale prej mbi 7 milionë eurosh në fushat e punësimit, mobilitetit të fuqisë punëtore dhe përfshirjes sociale dhe kulturore, mbrojtjes së mjedisit dhe turizmit. Ai shtoi se do të kontraktohet edhe një projekt nga lista rezervë, i cili do të rrisë përqindjen e kontraktimit në gati 100%. Në fund ai tha se në periudhën e ardhshme do të jenë në dispozicion fonde shtesë mbi 8 milionë për përfituesit në kuadër të programit IPA III.



Znj. Jelena Davidović, ushtruese e detyrës së shefes së Drejtorisë për Financa dhe Kontraktim të Fondeve të Asistencës së BE-së (CFCU) në Ministrinë e Financave të Malit të Zi njoftoi se projektet e përzgjedhura kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të Programit dhe se në realizimin e tyre do të përfshijë angazhimin e përbashkët të institucioneve dhe organizatave të shumta.

Ajo theksoi rëndësinë e fondeve ndërkufitare të Bashkimit Evropian që kontribuojnë në një cilësi më të mirë të jetës së qytetarëve që jetojnë në zonën e programit. Ajo po ashtu theksoi se ka pasur shumë interes nga aplikantët për këtë thirrje dhe se janë kontraktuar 10 projekte me vlerë 3.2 milionë euro dhe se pritet të kontraktohet edhe një projekt. Gjithashtu, ajo përgëzoi të gjithë përfituesit e projekteve dhe u uroi realizim të suksesshëm të projekteve.



Zëvendës shefi i Seksionit për Bashkëpunim në Zyren e Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Alessandro Biancarrdi, deklaroi se veprimet ndërkufitare kanë qenë gjithmonë vendimtare në mbështetjen e përpjekjeve zhvillimore të popullatës lokale për korrigjimin e pabarazive dhe trajtimin e pabarazive territoriale. Ai vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës dhe tha se ky program ndërkufitar synon të gjejë zgjidhje të përbashkëta për sfidat e përbashkëta, në mënyrë të qëndrueshme. Ai tha se 10 projekte të kontraktuara do të kontribuojnë prioritetëve të BE-së dhe prioritetëve të vendeve si tranzicioni i gjelbër, punësimi dhe përfshirja sociale, si dhe zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore. Ai theksoi se KE monitoron ndikimin e projekteve ndërkufitare në zhvillimin e rajonit ndërkufitar dhe përmirësimin e standardit të jetesës së popullatës në zonën e programit.

Në pjesën e dytë të ceremonisë, pas fjalëve hyrëse, shefje e SPT-së, znj. Sanja Todorović prezantoi shkurtimisht të gjithë procesin e Thirrjes së 3-të për dërgimin e projekt-propozime duke filluar nga publikimi i saj dhe informoi të pranishmit për të gjithë afatin kohor të aktiviteteve që janë bërë nga strukturat e Programit me qëllim informimin, zhvillimin e kapaciteteve të aplikantëve të mundshëm përpara dhe pas publikimit të Thirrjes.

FAKTE TË SHPEJTA - Projektet e Thirrjes së 3-të për projekt-propozime MNE-KOS

Trashëgimia kulturore – Vepro SMART, kurse ujin! – zbatuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim – QKD, Ujësjetllësi Sh.PK "Bistrica" nga Bijello Pole dhe Ujësjetllësi Rajonal "Hidrodrini" – Sh.A. Pejë;

Qasja e Re për Rigjallërimin e Mjedisit – NERA – zbatuar nga Komuna e Tuzit dhe Komuna e Pejës;

Të rinjtë NEET: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit – "UNEETED" – zbatuar nga Instituti për Studime dhe Prognoza Strategjike, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Oda Ekonomike e Malit të Zi dhe Komuna e Mojkovcit;

Aftësitë për Punësim të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkufitar të Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës – Pa Kufi! - zbatuar Oda Ekonomike e Malit të Zi, Oda Ekonomike e Republikës së Kosovës, Qendra Rajonale e Biznesit Berane dhe Instituti i Arsimit, Trajnimit dhe Hulumtimit – ETRI;

Rilindja Kulturore nga Liqeni i Shkodrës në Kosovë – TIME TRAVEL – zbatuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF), Qendra për Iniciativa turistike të Qëndrueshme, Komuna e Klinës dhe Organizata Nacionale Turistike e Malit të Zi;

Marrëveshja e gjelbër ndërkufitare - zbatuar nga FORS Mali i Zi, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë dhe Komuna e Beranës ;

Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore – Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizmin Kulturor – zbatuar nga I.P. Muzeu i Polimjes në Berane dhe Shoqata Alpinistike Marimangat e Pejës;

C.L.O.S.E.R. – Mundësitë e udhëhequra nga kultura për rivitalizimin e qëndrueshëm ekonomik - zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Trashëgimi Kulturore pa Kufij dhe Komuna e Tivarit;

Shndërrimi i fshatrave tona në destinacione turistike - zbatuar nga Komuna e Pejës, Agjencia për Zhvillim Rajonal Perëndim dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije;

Në Punësim, Arsim, Trajnim – IN EET – zbatuar nga OJQ-të Juventas dhe Labyrinth.



Në kuadër të pjesës së tretë të ceremonisë, projektet e përzgjedhura në kuadër të Thirrjes së 3-të për dërgimin e projekt-propozime në kuadër të IPA BNK programit Mal i Zi - Kosovë 2014-2020 u prezantuan nga përfituesit e projektit dhe në fund të ceremonisë u shfaq për herë të parë në Pejë filmi dokumentar me metrazh të shkurtër promovues i quajtur "Promovimi i eko-turizmit në territorin e Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës".



Në Prishtinë u mbajt takimi bilateral dhe ai i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta në kuadër të Programit të bashkëpunimit ndërkufitar (BNK) Mal i Zi – Kosovë, në Prishtinë më 13 shkurt të vitit 2023 është mbajtur takimi bilateral ndërmjet Strukturave Operative. Takimi u organizua me qëllim të diskutimit të aktiviteteve të vazhdueshme programore në kuadër të IPA II dhe IPA III. Në të njëjtën ditë u mbajt edhe takimi i Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (KPM) me qëllim diskutimin e hapave të mëtejshëm në lidhje me IPA III dhe detyrat e ardhshme.



Në Kosovë u organizua Punëtorja ndërkufitare për gazetarë

Sekretariati i Përbashkët Teknik organizoi një punëtori ndërkufitare për gazetarët në kuadër të Programit IPA BNK Mal i Zi-Kosovë me

mbështetjen e Strukturave Operative të Programit, me qëllim që të familjarizojë gazetarët nga Kosova dhe t'i inkurajojë ata të prodhojnë storie mbi rezultatet e arritura dhe rrëfime interesante nga projektet e financuara në kuadër të këtij Programi dhe në këtë mënyrë t'u afrojnë qytetarëve projektet dhe arritjet e tyre.

Punëtorja u mbajt më 28 mars të vitit 2023 dhe përfshinte vizitën e projekteve që ishin/janë duke u zbatuar në Komunat e Gjakovës, Deçanit, Pejës dhe Klinës. Gazetarët gjatë aktivitetit promovues u shoqëruan nga Gazmir Raci, zyrtar i Antenës së SPT-së në Prishtinë dhe Fatmire Berisha, Zyrtare Kombëtare e BNK-së nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës.



Në Komunën e Gjakovës ekipi i gazetarëve pati mundësinë të vizitonte Stacionin e Transferimit të Mbeturinave i krijuar në kuadër të projektit "Të Bashkuar Kundër Ndotjes – UAP" i financuar nga Thirrja e parë dhe të marrë informacion të detajuar nga përfituesit e projektit mbi aktivitetet e projektit dhe se si Ndërmarrja komunale "Çabradi" ka instaluar pajisje për ndarje dhe riciklim dhe ka vendosur kontejnerin kontrollues brenda objektit. Edhe në Komunën e Petnjicës në Mal të Zi është investuar në të njëjtën kohë në ndërtimin e Stacionit të Transferimit të Mbetjeve.



Pas vizitës në Gjakovë, ekipi i gazetarëve ka udhëtuar drejt Deçanit. Pritja e parë ishte nga kryetari i Komunës z. **Bashkim Ramosaj** në objektin e komunës dhe më pas vizita u drejtua në qendrën e maleve në Bjeshket Belegut.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqatës së bjeshkatarëve "Shkëlzen Haradinaj" nga Deçani. Siç u shpjegua të pranishmëve, në kuadër të zbatimit të projektit "Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara" rezultatet e pritshme parashikojnë ngritjen e dy qendrave turistike si në Mal të Zi ashtu edhe

në Kosovë, zhvillimin e produkteve turistike verore dhe dimërore dhe shërbimet si dhe shënjimi dhe promovimi i përbashkët i zonave të reja.



Më pas ekipi i gazetarëve ka udhëtuar për në Pejë në qendër të qytetit dhe ka vizituar investimet e bëra në kuadër të shenjimit të rrugës së trashëgimisë kulturore që lidh qytetin e Pejës në Kosovë me Gucinë në Mal të Zi.



Në Muzeun e Qytetit në Pejë, na priti udhëheqësi i sektorit të turizmit në Komunën e Pejës, **z. Virtyt Morina** si dhe **z. Sokol Luta**, drejtues i AZHR Perëndim i cili zbatoi projektin "Bjeshkët e Nemuna – destinacion i jashtëzakonshëm" dhe




Z. Nermin Kastrati, i cili ka qenë menaxher i "Trashëgimisë Kulturore – Thesar i Rajonit Ndërkufitar", projekti ndërkufitar që është udhëhequr nga Komuna e Pejës. Në fund të kësaj vizite njëditore në projektet e implementuara në programin IPA II BNK Mali i Zi-Kosovë, ekipi me gazetarë vizitoi Qendrën e Mjekësisë Familjare në Klinikë. Kjo qendër ka qenë përfituese e disa



pajisjeve shumë të nevojshme dhe të rëndësishme për shëndetin e nënës dhe fëmijës në kuadër të dy projekteve që janë zbatuar në Kosovë nga OJO

ECMI Kosova, " CARES – Veprimet ndër-kufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues" dhe " CARES 2 – Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues 2". **Dr. Gazmend Bojaj**, i cili është edhe ushtrues detyre i kësaj qendre të mjekësisë familjare, së bashku me dy motrat mjeke, foli për rëndësinë dhe ndikimin që kanë. këto dy projekte, sepse në fillim ishin skeptikë, por tani janë shumë të kënaqur dhe shprehin interes për përfshirjen e ardhshme në projektet e BNK.



Takimi i dy Kordinatorëve Kombëtar IPA në Podgoricë

Në muajin prill të vitit 2023, u takuan në Podgoricë Koordinatorët Kombëtar të IPA-së së Malit të Zi dhe Shqipërisë me qëllim diskutimin e projekteve të përbashkëta të financuara nga BE duke synuar forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë. **Znj. Millena Zhizhiq**, Sekretare Shteti në Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi dhe njëkohësisht Koordinatorë Kombëtare e IPA-së u shpreh se *“është e nevojshme që të arrihet cilësi më e lartë e bashkëpunimit në fushën e projekteve me interes të përbashkët, si dhe të punohet së bashku për të përmirësuar standardet dhe cilësinë e jetesës së njerëzve që banojnë në zonën ndërkufitare Mal i Zi – Shqipëri”*. Së bashku me bashkëpunëtorët e saj, ajo u takua me Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC), që njëkohësisht është dhe Koordinator kombëtar IPA-së për Republikën e Shqipërisë, **z. Ilir Beqaj**, për të diskutuar rreth programeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe rajonal në të cilat dy vendet marrin pjesë.



Znj. Zhizhiq theksoi faktin se këta dy vende kanë themeluar tashmë një bashkëpunim, por që është e nevojshme që në periudhën në vijim të zbatohen projekte me interes të përbashkët nën IPA-në aktuale por dhe nën IPA III, të cilat ofrojnë një numër të madh mundësish për projekte të rëndësishme.

Z. Beqaj, mirëpriti përpjekjet e Ministrisë së Çështjeve Evropiane në menaxhimin e programit, dhe prezantoi rezultatet e arritura nga Republika e Shqipërisë, si pjesë e strukturave operative të programit, me qëllim lehtësimin e zbatimit të projekteve nga përfituesit shqipëtar. **Z. Beqaj** theksoi rëndësinë e përqendrimit të energjive drejt projekteve strategjike në zonën ndërkufitare si përgjigje ndaj nevojave aktuale por edhe atyre që e ardhmja na imponon.



Drejtori i Përgjithshëm në detyrë i Drejtorisë së Fondeve Evropiane dhe Shefi i Strukturës Operative në Ministrinë e Çështjeve Evropiane, **z. Bojan Vujović** theksoi rëndësinë e këtij takimi ndërmjet dy Koordinatorëve Kombëtar IPA-së dhe tregoi nevojën për një qasje strategjike dhe përqendrim drejt prioriteteve konkrete për periudhën në vijim. Ai shtoi se ka një interes të lartë për fondet evropiane dhe se në kuadër të IPA II, organizata dhe institucione nga Mali i Zi marrin pjesë në rreth 280 projekte nga programe të ndryshme të bashkëpunimit territorial. Bashkëbiseduesit, shkëmbyen gjithashtu opinione lidhur me obligimet aktuale që burojnë nga programet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe territorial si dhe ranë dakord rreth një sërë hapash që duhen ndërmarrë lidhur me projekte të interesit të përbashkët për periudhën në vijim.

Ngritje kapacitetesh për përfituesit e projekteve të dy programeve

Gjatë kësaj periudhe u organizuan katër aktivitete për përfituesit e Thirrjes së 3-të për dërgimin e projekt-propozime nga programi Mal i Zi-Kosovë. Përkatësisht SPT-ja, siguroi asistencë teknike dhe administrative për seminarët që organizoi Autoriteti kontraktues në Podgoricë mbi përkurimet e nivelit të dytë dhe Zbatimin e projekteve. Trajnimet u përqendruan në procedurat dhe rregullat e BE-së për prokurimet e nivelit të dytë, për kërkesat e Aneksit IV në Kontratën e Grantit, si dhe për çështje të planifikimit dhe menaxhimit të projekteve dhe monitorimit të brëndshëm.



Në Istog, Kosovë u mbajtën trajnimet për përfituesit lidhur me raportimin dhe Vizibilitetin e projekteve. Trajnimet u dhanë nga SPT-ja, ku të pranishmit u paiseën me njohuri të detajuara rreth raportimit periodik dhe final si dhe me njohuri rreth teknikave dhe metodave të duhura të publicitetit dhe komunikimit sipas rregullave të BE-së.



Sipas të njëjtës qasje dhe përmbajtje, katër aktivitete u organizuan gjithashtu në periudhën shkurt-mars të vitit 2023 për përfutjesit e projekteve të Thirrjes së 3-të për dërgimin e projekt-propozime në kuadër të Programit Mal i Zi-Shqipëri. Përkatësiht CFU i Malit të Zi mbajti në Podgoricë trajnimin mbi rregullat e prokurimit të nivelit të dytë dhe seminarin mbi zbatimin e projekteve, duke përfshirë temat e njëjta lidhur me prokurimet sipas rregullave të BE-së, monitorimin dhe menaxhimin e projekteve.



Sekretariati i Përbashkët Teknikmbajti në Lezhë, Shqipëri, trajnimet mbi metodat e Raportimit dhe Publicitetit e Vizibilitetit për përfutjesit e thirrjes së 3-të për dërgimin e projekt-propozime.



Aktivite për ngritjen e kapaciteteve të organizuara për stafin e strukturave të programit

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të strukturave programore u organizuan trajnime në lidhje me prokurimin dhe komunikimin.





Aktiviteti i parë, i mbajtur më 3 shkurt të vitit 2023, u fokusua në ngritjen e kapaciteteve të **SO-ve dhe SPT-së mbi prokurimin e punimeve**. Qëllimi i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve në përputhje me rregullat e PRAG-ut (Udhëzues Praktik për Procedurat e Kontratës për Veprimet e Jashtme të KE-së) dhe përmirësimi i të kuptuarit të proceseve të prokurimit. Ngjarja u ndoq nga gjithsej 25 pjesëmarrës.

Ngjarja e dytë, një webinar i titulluar **"Komunikimi nën IPA CBC – Tregimi i historive"** u zhvillua online më 7 Mars të vitit 2023. Ai u organizua nga Programi Interact pas një kërkesë nga MEA, SASPAC dhe MAPL me mbështetjen e SPT.



Qëllimi kryesor i webinarit ishte të mblidhte përfaqësues nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë Strukturat Operative të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës, për të diskutuar teknikat efektive për transformimin e përshkrimeve të projekteve në tekste tërheqëse. Ngjarja u prit mirë, me 42 pjesëmarrës të pranishëm dhe tërhoqi vëmendjen nga të gjitha programet përkatëse IPA.



»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministry
of European Affairs



Montenegro
Ministry of Finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo lokalne samouprave
Ministry of Local Government



SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik

E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat

E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti

E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ

E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,
Kosovë

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë

E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



@cbc.mne.alb



@cbc.mne.kos



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian